



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 626/1 prot.

Shkodër, më 7.10.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 55, datë 23.09.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 29, neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 30/gj, neni 41/2, 65/1 & 3, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, të VKB nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile", të VKB Vau Dejës nr. 72, datë 23.12.2021 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Vau Dejës", të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 5022 prot., datë 28.09.2022 "Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 23.09.2022", shkresa e AKMC drejtuar bashkisë Vau Dejës mbi fondin e kushtëzuar nr.1007/1 prot, datë 17.6.22, shqyrtoi **VKB Vau Dejës nr. 55, datë 23.09.2022 "Dhënie e ndihmës financiare, kompensim 8 familjeve të dëmtuara nga zjarri gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022"**, për përballimin e dëmeve të shkaktuar nga zjarri në banesat e tyre, në shumën prej 3.302.158 lekë, nga fondi i kushtëzuar i Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile, në programin 10910 "Emergjencat Civile".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 55 datë 23.09.2022

Mbi

Dhënien e ndihmës financiare familjeve të dëmtura nga zjarri për vitin
2020 & 2021 & 2022

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore” i ndryshuar ,Ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, Vendimi Nr.414 dt.08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile, si dhe në shkresën Nr.1007/1 prot dt.17.06.2022” Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022”, të AKMC e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.3567 Prot dt.22.06.2022, si dhe pas shqyrtimit të projekt vendimit Nr.3 dt.15.09.2022, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile, ku propozohet dhënia e ndihmës financiare për shtetasit banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri gjatë viteve 2020, 2021 & 2022 banorë të Bashkisë Vau-Dejës:

Pas diskutimit dhe miratimit me shumice të cilësuar votash,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare prej **3.302.158** (tremilion e treqind e dy mije e njëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë për 8 (tetë) shtetasit e Bashkisë Vau-Dejës të dëmtuar në 20% e vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesat e tyre nga djegia e banesave gjatë vitit 2020, 2021 dhe 2022 si me poshte:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa	Vlera Totale e Dëmit	Traj.sipas VKB Nr/ date	Shuma e kaluar Sipas VKB 30%	Shuma e mbetur per tu paguar total ne leke
1.	Pëllumb	Pjetër	Hila	Nj.A.Bushat	399.862	VKB Nr.13 dt.25.02.2020 konf.shkr.211/1 dt.12.03.2020	120.000	79.972
2.	Gezim	Gjergj	Luka	Nj.Admin.Vau-Dejes	406.540	VKB Nr.14 dt.25.02.2020 konf.shkr.212/1 dt.12.03.2020	122.000	81.308
3.	Ben	Bib	Gjinaj	Nj.Admin.Vig Mnele		VKB Nr.15 dt.25.02.2020 konf.shkr.213/1 dt.12.03.2020	585.000	389.719
4.	Çesk	Pal	Daja	Nj.Admin.Haj mel	1.504.078	VKB nr.17 dt.25.02.2020 konf.shkr.215/1 dt.11.03.2020	450.000	300.816



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5.	Gjon	Lek	Markaj	Nj.Admin.Vau-Dejes	269.980	VKB Nr.28 dt.24.04.2020 konf.shkr.312/1 dt.11.05.2020	80.994	53.996
6.	Andi	Gjergj	Ndoj	Nj.Admin.Hajmel	626.190	VKB.Nr.27 DT.24.04.2020 Konf.shkr.311/1 dt.11.05.2020	187.857	125.238
7.	Nikolin	Ded	Hiluku	Nj.Admin.Vau-Dejes	6.691.126	VKB Nr.52 dt.26.08.2021 konf.shkr.610/1 dt.10.09.2021	2.007.338	1.338.225
8.	Nikoll	Zef	Pecaj	Nj.Admin.Vig Mnelë	4.664.421	VKB Nr.15 dt.28.03.2022 konf.shkr.225/1 dt.14.04.2022	1.399.326	932.884
Shuma								3.302.158

- Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banoreve të dëmtuar.
- Burimi i financimit** do të jetë fondi i kushtëzuar i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “i cili është miratuar në rishpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile për vitin 2022” që është bërë i disponueshëm në Sistemin Informatik financiar të Qeverisë sipas shkresës Nr.1007/1 prot dt.17.06.2022” Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022”, të AKMC e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.3567 Prot dt.22.06.2022.
- Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances) për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar).

KRYETAR

Sekretari i Këshillit Bashkjak

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 28.09.2022

